



Pranuar / Dorezuar Priljena/Prodato Received/Delivery	31.12.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SRPMSBICK	6471/2021		1/7



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.964/2021**

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti- kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi Bajraktari- anëtar, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.964/2021 të datës 24.11.2021 të parashtruar nga grup ankuesish të përfaqësuar nga avokati me adresë Rruga "Gjergj Fishta"nr.22, Lipjan, kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 30.12.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.964/2021 e datës 24.11.2021 e parashtruar nga ankuesit: dhe
- II. Shpallet jo kompetent Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesve dhe

**A r s y e t i m**

Ankuesit dhe të punësuar në Policinë e Kosovës, sipas kontratave të punës me kontratë të punës të datës 16.06.2014, në pozitën "Zyrtare e lartë për media", me kontratë pune të datës 13.12.2013 në pozitën specialist në tavolinën ndihmëse", me kontratë pune të datës 17.11.2014 në pozitën "Ekspert i Teknologjisë informative", me kontratë pune të datës 06.04.2012 në pozitën "Zyrtare e lartë e aseteve" dhe me kontratë pune të datës 25.11.2013 në pozitën "murator(technik i ndërtimit", me datën 18.08.2021, përmes përfaqësuesit ligjor avokatit kanë parashtruar kërkesë tek Drejtoria e Personelit në Policinë e Kosovës për kompensimin e shpërblimit të një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore për vitin 2018, 2019 dhe 2020, shujtën ditore dhe të drejtat tjera bazuar në

Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Drejtoria e Personelit të Policisë së Kosovës me datën 30.08.2021, ka njoftuar përfaqësuesin e ankuesve se është refuzuar kërkesa lidhur me kompensimin e lartcekur për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore nga ana e Policisë së Kosovës.

Përfaqësuesi i ankuesve , me datën 24.11.2021, ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 5641/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e shujtës ditore dhe tri (3) pagave në emër të një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore për vitet 2018,2019 dhe 2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 01.12.2021, ankesën e ankuesve e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës. Me datën 09.11.2021, Policia e Kosovës përmes Departamentit për Burime Njerëzore, ka përcjellë gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesve e datës 24.11.2021, me numër protokollit 5641/2021 e parashtruar përmes avokatit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimet e datës 29.10.2021; Përgjigje në kërkesë e datës 05.11.2021 nga Drejtori i Divizionit për Personel dhe Administratë, Autorizimi i datës 20.10.2021; Autorizimi i datës 02.09.2021; Autorizimi i datës nga organi i punësimit e datës 09.12.2021 me numër protokollit 5935/2021 bashkë me shkresat e lëndës, Kontratë pune e datës 16.06.2014, Kontratë pune e datës 13.12.2013; Kontratë pune e datës 17.10.2011; Kontratë pune e datës 25.11.2013; Kërkesë e datës 28.05.2021; Memorandumi zyrtar i datës 09.08.2021 dhe e-mail zyrtar i datës 22.04.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka vërtetuar se ankesa e ankuesve dhe  
**është e pa bazuar,ndërsa sa i përket ankesave të ankuesve dhe**  
**KPMSHCK-ja, Shpallet jo kompetent ,sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesve lidhur me realizimin e kompensimit të pagesës për shujtën ditore si dhe pagën e 13-të sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës të datës 14.11.2018, si dhe pagesën në mënyrë retroaktive për kompensimet e lartë cekura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesve të cilët kanë pozita; sipas kontratave të punës: me kontratë të punës të datës 16.06.2014, në pozitën "Zyrtare e lartë për media", me kontratë pune të datës 13.12.2013 në pozitën specialist në tavolinën ndihmëse", me kontratë pune të datës 17.11.2014 në pozitën "Ekspert i Teknologjisë informative", me kontratë pune të datës 06.04.2012 në pozitën "Zyrtare e lartë e aseteve" dhe me kontratë pune të datës 25.11.2013 në pozitën "murator(technik i ndërtimit", ka konstatuar se duke u bazuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës së ankuesve në Policinë e Kosovës, në bazë të nenit 3 paragrafin 5 të Ligjit Nr.3/L-149 për Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës, ankuesit janë nëpunës



të punësuar në Policinë e Kosovës, siç e përcakton kjo dispozitë: *"5. Personeli civil i punësuar në Policinë e Kosovës, në Forcën e Sigurisë së Kosovës, në Doganat e Kosovës, në Shërbimin Korrektues të Kosovës, është pjesë e shërbimit civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi"*, që në kohën kur është miratuar Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës dhe aktet nënligjore që zbatohen për këtë fushë, respektivisht neni 4 paragrafi 1, të këtij ligji, i cili ka përjashtuar vetëm zyrtarët policor nga shërbimi civil në Policinë së Kosovës, mbi këtë bazë për veç tjerash të gjitha pagat e nëpunësve civil dhe shtesat e nëpunësve civil të Policisë së Kosovës, rregullohen në bazë të nenit 4 paragrafi 1 dhe paragrafit 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, të cilat ende kanë fuqi ligjore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar nenin 44 paragrafi 2 si dhe duke u ndërlidhur me neni 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës mbi të cilën bazë juridike Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, ka kompetencë për nxjerrjen e akteve nënligjore që rregullojnë marrëdhënien e punës për personelin policor dhe mbi të cilën bazë juridike ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës të datës 14.11.2018 por se që ky udhëzim do të duhej të jetë në harmoni me bazën ligjore që veç është e rregulluar një materie konkrete, mbi këtë bazë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ekziston baza ligjore që e rregullon çështjen e pagave dhe shtesave të ndryshme të nëpunësve civil, siç është Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregullorja Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, rrjedhimisht dispozitat e Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës, nuk mund të parashohin të drejta dhe beneficione ndryshe nga si është e rregulluar kjo çështje me Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, prandaj pretendimet e ankueses janë të pabazuara.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e shqyrtimit të ligjshmërisë se pretendimeve ankimore të ankuesve, ka konstatuar se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe i cili është dekretuar nga Presidenti i republikës së Kosovës më datë 14/06/2010, i cili aktualisht është në fuqi dhe në dispozitën e nenit 14 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij ligji, ka përcaktuar se: *"1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut"*, si dhe neni 4 i Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera, mbi pagën bazë të nëpunësve civilë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës me rastin e nxjerrjes së Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, nuk ka marrë për bazë dispozitat e nenit 14, 15, 16, 17 dhe 19 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, si dhe nenit 4 të Rregullores Nr.33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil, sepse në dispozitat të këtij udhëzimi janë përfshirë edhe shtesa dhe beneficione tjera, dhe të cilat në raport me dispozitat e ligjit për paga Nr.03/L-147 dhe rregullores Nr.33/2012 që specifikisht rregullojnë këtë fushë nuk mund të kenë fuqi mbizotëruese për nëpunësit civil gjegjësisht stafin civil në Policinë e Kosovës, andaj si i tillë Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës



në Policinë e Kosovës nuk është i zbatueshëm për këtë kategori të nëpunësve civil brenda institucionit të Policisë së Kosovës.

Lidhur me zbatimin e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, me datë 09.12.2021 Policia e Kosovës, në përgjigjen e dhënë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në të cilën është deklaruar se për zbatimin e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, Policia e Kosovës ka bërë përpjekje për buxhet shtesë tek Ministria përgjegjëse me datë 24.10.2017, duke parashtruar kërkesë tek Ministria e Financave, përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme, për sigurimin e mjeteve buxhetore shtesë për kategorinë e pagave dhe mëditjeve sipas Qarkores me numër Ref.2018/02 për periudhën 2018/2020, dhe e cila kërkesë nuk është aprovuar nga Ministria e Financave.

Në rastin konkret sipas këtij deklarimi zyrtarë të Policisë së Kosovës, është vërtetuar fakti se para se ta miratojë Udhëzimin Administrativ të datës 14.11.2018 Policia e Kosovës ka qenë dashtë të ketë një miratim nga Ministria e Financave konform nenit 47 paragrafi 4 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës e që në këtë mënyrë përmbajtjen dhe formën e kësaj rregullore e bënë pa bazë ligjore sa i përket kësaj kategorie të nëpunësve civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se nëse marrim për bazë dispozitën e Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës respektivisht nenin 1 ku shprehimisht thuhet: *“Ky ligj rregullon autorizimet dhe detyrat e policisë së Republikës së Kosovës, organizimin e saj dhe çështje tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e policisë së Republikës së Kosovës”*, ndërsa mbi këtë bazë të specifikuar më lartë mund të nxjerrët konstatimi se edhe Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës sa i përket beneficioneve, duke përfshi kompensimin e shujtës ditore, pagës së 13-të (për vitet 2018,2019 dhe 2020) dhe pagën jubilarë të nëpunësve civil është në kundërshtim me vetë ligjin e policisë sepse kjo çështje është e rregulluar me legjislacion sa i përket nëpunësve civil dhe se udhëzimi në të cilin thirret ankuesi ka të bëjë vetëm me zyrtarë policorë e jo edhe staf civil përkundër që në këtë udhëzim pa bazë ligjore janë potencuar edhe personeli i policisë në cilësi të stafit civil.

Po ashtu, nëse i referohemi nenit 47 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës sa i përket pagave dhe kompensimeve tjera kolegji konstaton se nëse shihet përmbajtja e paragrafit 1,2 dhe 5 të këtij neni mund të konstatohet se pagat dhe kompensimet tjera sipas këtij ligji i referohen vetëm zyrtarëve policor por jo edhe stafit civil të policisë dhe se nga këto dispozita të potencuara rezulton që edhe Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës kur parasheh beneficione të ndryshme për stafin civil është në kundërshtim me vetë përmbajtjen e ligjit të policisë respektivisht nenin 47 paragrafi 4 në të cilin thuhet: *“pagat themelore dhe çdo shtesë e autorizuar përcaktohet dhe paguhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin në fuqi dhe aktet nënligjore. Drejtori i Përgjithshëm, me miratim të ministrit mund të përfshijë në buxhetin vjetor të policisë propozimin për shumat që nevojiten të përdoren për pagimin e çfarëdo pagese shtesë të autorizuar me ligj”*, andaj edhe mbi bazë të këtyre rrethanave nuk mund të zbatohet për nëpunësit civil brenda këtij institucioni pasi këto çështje janë të rregulluara specifikisht me Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, si dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil.



Andaj, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se, Policia e Kosovës edhe për kundër faktit se nuk është aprovuar kërkesa e datës 24.10.2017 nga Ministria e Financave, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës prapë në kundërshtim me nenin 47 para paragrafin 4 të Ligjit Nr.04/L-076 për Policinë e Kosovës, ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, duke vepruar në kundërshtim me dispozitën ligjore të nenit 19 paragrafi 1 dhe 2 si dhe nenin 23 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ku përcakton se: *"1. Institucionet e administratës publike çdo vit, së bashku me kërkesën vjetore për buxhet, dorëzojnë në ministrinë përgjegjëse për financa shumë e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve për shtesat mbi pagën bazë në institucionin përkatës. 2. Institucionet e administratës publike çdo vit mund t'i paguajnë shtesa stafit të tyre vetëm me kusht që shuma e përgjithshme e shtesave dhe pagave bazë të jetë përcaktuar nga ministria përgjegjëse për financa, brenda llogarisë së përgjithshme të përcaktuara për institucionin përkatës", dhe nenin 23 "Institucionet e administratës publike çdo vit, së bashku me kërkesën vjetore për buxhet, dorëzojnë në ministrinë përgjegjëse për financa shumë e nevojshme për kompensimin dhe pagesat e tjera për institucionin përkatës", që në rastin konkret Policia e Kosovës, mbi këtë bazë nuk ka dëshmuar me asnjë provë se ka ekzistuar miratimi i Ministrisë përgjegjëse për nxjerrje dhe zbatim të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, sa i përket planifikimit buxhetor, andaj edhe pretendimet e ankueses mbi bazë të dispozitave ligjore të specifikuar më lartë janë të pabazuara.*

Andaj si përfundim rreth pretendimeve ankimore të ankuesve për pagesën e shujtës ditore, pagën e 13-të si dhe shtesat në pagë për kualifikimin shkollor (për vitet 2018,2019 dhe 2020), Kolegji konstaton se janë tërësisht të pabazuara dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, dhe nenit 21 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, nga se me asnjë dispozitë ligjore që rregullojnë shërbimin civil nuk parashihen këto beneficione, po ashtu këto kërkesa janë të vjetruara edhe sikur kjo rregullore të prodhoj efekte juridike ndaj kësaj kategorie të nëpunësve civil nga se si kërkesa janë jashtë afateve ligjore të përcaktuara në dispozitat e nenit 127, paragrafi 1. të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"* e që në rastin konkretë kemi të bëjmë me pretendime ankimore që rrjedhin nga një Udhëzimi Administrativ Nr.02/2018 i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës ndërsa ankuesit nuk kanë dëshmuar me asnjë provë se kanë parashtruar ndonjëherë kërkesë në organin e punësimit, ndërsa kërkesat me pretendimet e paraqitura në këtë ankesë janë jashtë çdo afati ligjor sa i përket kësaj natyre të çështjes.

Po ashtu, bazuar në dispozitën ligjore në fuqi gjegjësisht të nenit 85 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik, ku përcaktohet se: *"Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj",* i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit GJK-KO203/19-AKV të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka shfuqizuar Ligjin për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 dhe çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me këtë ligj, rrjedhimisht shfuqizohet çdo akt tjetër që është në kundërshtim me këtë ligj, duke përfshirë dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2018 të datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, që është nxjerrë në kundërshtim me këtë ligj, ndërlikur dhe me dispozitat transitorë të nenin 83 për dispozitat transitorë, të këtij ligji, ku përcakton se: *"1. Nëpunësi civil në marrëdhënie pune në Shërbimin Civil, në pajtim me Ligjin e Shërbimit Civil (03/L-149) dhe që mban një pozitë ekuivalente me pozitën e nëpunësve civilë sa i*



*përket funksioneve dhe përgjegjësi, konsiderohet nëpunës civil sipas nenit 2, paragrafi 3 të këtij ligji, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji”*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në fushë veprimtarinë e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i njëjti është kompetent të shqyrtoj vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil ashtu siç është përcaktuar me nenin 6 paragrafin 1 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se: **“Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil”**, andaj bazuar në këtë, meqenëse ankuesit dhe nuk e kanë statusin e nëpunësit civil dhe në bazë të vendimeve për dorëheqje të datës 16.10.2020 dhe të datës 17.08.2021, andaj në bazë të nenit 24 paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se *“3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimi në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative. 4. Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente”*, atëherë në kuptim të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesit.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda ,A.nr.964/2021,datë 30.12.2021

Sabile AVDYLI



Zyrtare i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Avokatit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

